



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 22. 09. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic, anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF
5. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
6. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
7. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
8. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
9. Feti Krasniqi, Drejtor i BPZHR
10. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
11. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
12. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
13. Ahmet Maksuti , zyra ligjore
14. Hasan Zeqiri, zyrtar i protokolit
15. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
16. Bekim Krasniqi, "YAGR"
17. Bukuriye Zejnullahu, zyra për informim
18. Përfaqësuesit e mediave
19. Numër i konsideruar i qytetarëve
20. Naser Bytyqi, perkthyes shqip-serbisht
21. Rifat Hoxha,
22. Haki Avdiu, zyrtar per zërim

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti Sami Murati.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 24 anëtarë nga gjithsej 31 hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë dhe për këtë mbledhje kemi 7 pika të rendit të ditës dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës.

Pastaj pyeti anëtarët se a ka dikush të shtojë rreth rendi të ditës?

Nazmi Krasniqi, tha se në këtë mbledhje është dashtë të jetë një pikë e rendit të ditës lidhur me arsimin pasi që ka përfunduar viti shkollor e gjithashtu ka filluar edhe viti i ri shkollor dhe është dashtë që të njoftohet për këto por besoj se në mbledhjen e ardhshme do të jetë në rend dite kjo pikë.

Edita Gashi, kam vërejtje që nuk është respektu Plan i Punës që e kemi aprovu në Kuvend ku atëherë kam propozu që në korrik të paraqitet një raport për shqyrtim për të korrurat dhe atëherë është thënë se në korrik nuk mund të paraqitet për shkak se nuk përfundojnë të korrat kurse tani jemi në shtator dhe ky raport nuk është sjellë për shqyrtim në Kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth rendit të ditës, Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për 1 apstenim, kundër nuk pati Kuvendi për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e KK-së
2. Propozim Vendim për aprovimin e Buxhetit 2016-2018
3. Propozim Vendim mbi miratimin e ridestinitimit dhe transferit të mjeteve buxhetore për vitin 2015
4. Propozim Rregullore mbi caktimin e tarifave për tatimin në pronë.

5. Propozim Vendim për caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në Qendren për Edukimin dhe Arsimimin Parashkollor në Lipjan
6. Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.
7. Propozim Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim Afatëshkurtër të pronave të paluajtëshme të Komunës-Tokave Bujqësore

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush të shtoj diqka.

Florent Hoxha, në mbledhjen e kaluar të Kuvendit si GP i PDK-së kemi kërkuar nga Drejtorati i Shërbimeve Publike që në rrugën "Qamil Olluri" të mbyllet një gropë por kjo nuk është bërë, andaj kërkojmë që kjo gropë që po rrezikon qytetarët të mbyllet më parë.

Qështje tjetër është që përmendi edhe Nazi që në mbledhjen e ardhshme të paraqitet një informatë për gjendjen në arsim në të kundërtën na do të detyrohem të thirrjmë mbledhje të jashtëzakonshme.

Blerim Gashi, para fillimit të vitit të ri shkollorë ishte një informatë se me 1 shtator do të fillon punën objekti i ri i gjimnazit, mirëpo kaluan edhe një muaj dhe mësimi nuk ka filluar në këtë objekt, andaj pyes Drejtorin se kur do të filloj punën ky objekt.

Ramiz Qeriqi, kam një kërkesë që në mbledhjen e ardhshme në rend të ditës të hynë ndarja e banesave në pronësi të Komunës sepse njerëzit kanë nevojë të mëdha kurse banesat janë duke nejtë thatë.

Kërkesë tjetër kemi nga fshati Rubovc dhe Kojskë meqë transportuesi që bartë nxënësit me minibus nuk i plotëson kushtet teknike andaj kërkesa është që të shtohet edhe një minibus.

Te fshati Resinovc në udhëkryqin e rrugës Cërnavë Komoran të vëhet një pasqyrë nëse ka mundësi Komuna. Në fund tha se nxënësit që nuk kanë libra mos të largohen nga mësimi nga arsimtarët.

Hajrije Salihu, edhe unë ndaj shqetësimit me Blerimin për fillimin e punës në objektin e ri të gjimnazit e gjithashtu kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të paraqitet një informatë për qështjen e arsimit.

Enver Kozhani, kërkoj që në qendrën kryesore QKMF laboratorin të furnizohet me material meqë në mungesë të materialeve kam qenë prezent aty kur qytetarët janë orientuar që të shkojnë në laboratorët private.

Ali Stublla, kërkoj që për fshatin Topliqan Komuna të shqyrton mundësinë për zgjerimin e varrezave meqë në varrezat ekzistuese nuk ka vend të mjaftueshëm.

Rasim Hasani, së pari po i përgjigjem Luanit se për shkak të mungesës së librave nuk guxon të ndodh që të largohen nxënësit nga procesi mësimor.

Sa i përket gjimnazit nga Sekretari i përhershëm i Ministrisë kemi marrë një shkresë që objekti nuk mund të filloj punën me 1 shtator deri sa nuk bëhet kyqja në kanalizim dhe rrymë dhe për këtë kemi bërë kërkesë për kyqje në kanalizim dhe rrymë, mirëpo na nuk e kemi në mbikëqyrje këtë objekt por Ministria e Arsimit dhe unë kam kërku me shkrim nga Ministria e Arsimit që të na njoftoj por ende nuk kemi marrë përgjigje gjer më sot me përjashtim përveq një SMS që kanë thënë se me 1 shtator nuk mund të filloj mësimi në këtë objekt.

Meqë qështje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 20-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, asnjë kundër, asnjë apstemim

Aprovoi
Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 20-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II
Propozim Vendim për aprovimin e Buxhetit 2016-2018

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni. Fillimisht njoftoi anëtarët e Kuvendit se për këtë propozim të buxhetit, ekzekutivi ka mbajtur dëgjime publike e gjithashtu edhe KPF-ja e ka shqyrtu këtë propozim buxhet dhe ka mbajtur dëgjim publik me qytetarë.

Pastaj i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me procedurat e hartimit të propozim buxhetit për vitet 2016-2018 e pastaj njoftoi me të dhënat nga propozimi i buxhetit.

Në fund propozoj që Kuvendi të aprovoj këtë propozim buxhet me një vërejtje apo rekomandim për Ministrinë e Financave në mënyrë që Ministria të mbulon shpenzimet për mungesën e mjeteve në shumë prej 201.320,00€ në kategorinë e pagave dhe medijave.

Agron Hajdini, na me kohë e kemi pranuar materialin dhe parashikimin e buxhetit për vitet 2016-2018.

Te mallërat dhe shërbimet po shihet se ka zvogëlim të mjeteve dhe me këtë zvogëlim do të rriten të hyrat të investimit kapitalë, gjithashtu për vitin 2016 shihet se te planifikimi të subvencionet është rritur në Bujqësi, Kulturë, Rini dhe Sport.

Na si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë buxhet.

Blerim Gashi, sot kemi para vetës një dokument të rëndësishëm buxhetin e Komunës ku me këtë Komuna e kthen borgjin ndaj qytetarëve.

Kërkesat e qytetarëve janë shumë të mëdha por konsideroj se ekzekutivi ka gjetur mesin në mes të nevojave dhe mundësive.

Pozitive për këtë buxhet është rritja e subvencioneve për shtatë herë në bujqësi dhe këtë e kam kërkuar edhe më herët.

Qështje tjetër pozitive është edhe zvogëlimi i mjeteve për hartimin e projekteve.

Në shpërndarjen e investimeve kapitalë ka vend për përmirësim por unë nuk do të përmendi me emra meqë nuk dua të bëhem lokalist.

Te zvogëlimi i mjeteve në mallëra dhe shërbime unë kam kërkuar që në emër të zvogëlimi të këtyre mjeteve mos të mbesin keq furnizimi në shkollë.

Florent Hoxha, propozimi i këtij buxheti për vitin 2016 unë nuk e ndjeva se është bërë në bazë të strategjive të zhvillimeve ekonomike të cilat janë aprovu më herët në këtë Kuvend.

Pastaj tha se ndarjen e buxhetit e kemi bërë për interesa politike e jo për interesa të qytetarëve dhe si shembull po e marr se vendëvotimet tradicionale që kanë votuar për PDK-në siqë janë Shala, Krojmiri, Resinovci, Kraishta, Topliqani etj nuk është parapa asnjë projekt i ri. Në vazhdim paraqiti fjalën e përgatitur me shkrim.

Xhevat Olluri, është mirë që po bisedohet për këtë buxhet dhe nevojat e qytetarëve dhe në kuadër të kësaj në KPF kam përmendur se te zvogëlimi i mjeteve në mallëra dhe shërbime mos janë lënë anash furnizimet në arsim dhe shëndetësi dhe nëse kjo ndodh për mua është e pa pranueshme.

Te investimet kapitalë nuk e di sa janë me vend propozimet por kam një pyetje se për nxemjen qëndrore të qytetit a është bësëdu meqë ka qenë një projekt.

Pastaj tha se kam një propozim konkret që nga mjetet e planifikuara për asfaltim të hiqen 40 mijë euro dhe këto mjete të orientohen për ndërtimin e nënkalimit të hekurudha.

Edita Gashi, te investimet kapitale sipas këtij buxheti janë vetë 3 milion dhe shumica e këtyre mjeteve shkojnë vetëm për asfalte dhe jo për zhvillim ekonomik dhe punësim andaj ky buxhet nuk merr mbështetjen e Vetëvendosjes.

Ukë Kryeziu, unë falenderoj ekzekutivin për planifikim të këtij buxheti i cili është ndarë në bazë të rregullave me përqindje. Në vazhdim përmendi shumat e planifikuara për shëndetësinë primare duke shtuar se me këtë planifikim nuk janë parapa shpenzimet për punën e natës si dhe vikendeve andaj kërkoj nga Drejtori që të shqyrton mundësinë e ndarjes së mjeteve në shumë prej 42.311,00€ për mbulimin e shpenzimeve për punë të natës dhe vikendeve.

Enver Kozhani, investimet kapitale nuk janë ndarë në mënyrën më të mirë të mundëshme meqë ka fshatra që janë parapa 3-4 projekte e ka fshatra që nuk është parapa asnjë projekt. Unë propozoj që për vitin 2016 të parashihet vendosa e kamerave për qytetin e Lipjanit për shkaqe të sigurisë.

Pastaj propozoj kanalizimin për fshatin Leletiq, asfaltimin e rrugës Bainsë që lidhet me Shalën, rregullimin e dyerve dhe dritareve për shkollën fillore Ribar i Madh e që këtë e kam kërkuar edhe në vitin e kaluar.

Për Ribar të Madh për vitin e ardhshëm është mirë që është paraparë rregullimi i trotuareve por këto mjete nuk mjaftojnë për shtruarjen e të gjitha trotuareve, andaj kërkoj që të shtohen mjete. Në fund kërkoj që të parashihet asfaltimi i rrugëve për dy lokacioneve e varrezave.

Linda Shahini, u përmend fshati Magurë dhe u tha se rrugët janë shtru aty ku është anëtarësia e LDK-së ndërsa që qon kah Kryetari i PDK-së në Magurë nuk është shtru. Gjithashtu tha se ju e dini se 6 vjet që keni qenë në pushtet në Magurë kemi vuajt për ujë dhe Kryetari Shukri Buja ka thënë në këtë sallë se edhe nëse vijë në pushtet uji nuk mund me u rregullue.

Rrugët në Magurë për fat të mirë po shtrohen dhe jo vetëm aty ku është anëtarësia e LDK-së por edhe ato rrugë ku janë edhe anëtarët e PDK-së. Gjatë takimeve që kemi pasur me qytetarë në Magurë, Kryetari i PDK-së në Magurë ka kërkuar nga Kryetari rregullimin e trotuareve në rrugën kah shkolla dhe me buxhet është parapa që të shtrohen trotuarët kah shkolla.

Florent Hoxha, unë nuk thash se jam kundër investimeve kapitale në Magurë dhe sa i përket ujit të pijes ne kemi bërë shumë kërkesa në AKP e në fund edhe në Qeveri për zgjidhjen e problemit të ujit në Magurë dhe ju e dini se problem ka qenë edhe borgji i mbetur për rrymë që kërkuar sun e ka marr për sipër pagesën e këtij borgji.

Petrit Kelmendi, propozoj që me këtë buxhet të parashihet zona ekonomike projekti i Lumit "Sitnica", mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara si dhe të përmenden emrat e rrugëve të cilat duhet asfaltuar meqë tani i kemi emrat.

Valbona Shillova, investimet kapitale nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabart dhe shembull po e marr për fshatin Topliqan që disa vite nuk është parapar asnjë projekt.

Dua të përkujtoj se fshati Topliqan nuk ka ujë të pijes, Lumi "Sitnica" për qdo vit vërshon sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore dhe bujqëve u shkaktohen dëme të mëdha.

Ali Stublla, te pagat dhe meditet për vitin 2016 është parapa shuma e 8.600.000,00€ kurse për vitin 2017 janë parapa 9.650.000,00€ e gjithashtu te mallërat dhe shërbimet për vitin 2016 722.000,00€, ndërsa për vitin 2017 824.000,00€ dhe te këto dy kategori është një rritje e madhe andaj duhet të na i spjegoj Drejtori pse është kjo rritje si te pagat dhe meditet ashtu edhe te mallrat dhe shërbimet. Te Jeta e re nuk ka asnjë projekt të paraparë deri në vitin 2018 a dihet se në këtë vendbanim kanalizimi, uji, rrugët asnjëri prej këtyre projekteve nuk kanë përfunduar dhe kërkoj spjegim pse nuk është parapa asnjë projekt. Në vazhdim tha se për shkollën "Adem Gllavica" janë parapa investime në vitin 2018 dhe pyes pse nuk është

parapa në vitin 2016 në mënyrë që të bëhen dy shkolla të reja meqë tani po dëgjoj nga nxënësit që nuk shkojnë në shkollën e vjetër po të rejen.

Nazmi Krasniqi, për mua është brengosëse planifikimi i mjeteve të pa definuara si shembull deponitë e egëra që nuk e di se inspektorët a kanë ndërmarr diçka për këto deponi. Gjithashtu jam i pakënaqur me planifikimin e rrugëve në Lipjan meqë janë parapa 240 mijë euro për asfaltimin e këtyre rrugëve a nuk dihet se për cilat rrugë bëhet fjalë. Gjithashtu është parapa rregullimi i 7-8 trotuarëve dhe unë nuk e di se cilat trotuare kanë me u rregullu meqë nuk janë përmend me emëra. Unë nuk jam kundër këtyre investimeve por konsideroj se më mirë ka qenë që të investohet në shkolla dhe në ngritjen e cilësisë në arsim.

Merita Hajrizi –Zeqiri, e dimë se ky buxhet nuk mund t'i përmbush të gjitha nevojat e qytetarëve por unë nuk pajtohem për planifikim të 4-5 projekteve për rrugë dhe asnjë projekt për ujësjellës a dihet se shumë fshatra janë pa ujësjellës e ndërto është edhe fshati Hallaq i Madh.

Imri Ahmeti, fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe më pastaj tha se me këtë buxhet nuk mund të jemi të kënaqur në raport me gjendjen që kemi në teren. Sigurisht edhe ju e keni pa se me këtë buxhet kemi zvogëlu shpenzimet e lluksit dhe kemi rritë investimet kapitale e gjithashtu kemi rritë subvencionet në bujqësi që është hera e parë e kësaj rritje e që përveq kësaj kemi rritë edhe subvencionet për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në qdo lokalitet kemi pas debate publike për buxhet dhe kërkesë imediate e qytetarëve ka qenë asfaltimet e rrugëve, gjithashtu tha se në bazë të kërkesave të qytetarëve është projektu ky buxhet.

Ne jemi të interesuar për ndërtimin e shkollave meqë siqë e dini edhe në Magurë edhe në Mirenë dhe Rubovë duhet të ndërtojmë shkollat e reja dhe për ndërtimin e shkollave do të kemi edhe grante nga donatorë të ndryshëm.

Për shkollën e Rubovcit do të konkurojmë në ambasada të ndryshme. Gjithashtu për vitin e ardhshëm do të ndërtohet shkolla në Bujari.

Për kanalizime kemi disa kontrata në gjysëm siqë është kontrata për Rubovc dhe Blinajë.

Për ujësjellës do të nënshkrujë marrëveshjen me CDEF-in për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit që më herët është thënë për 20 fshata por nuk kanë qenë 20 dhe me këtë projekt do të përfshihen Hallaqi i Madh, Jeta e Re dhe Topliqani.

Me projektin e mëhershëm të CDEF-it nga burimet e ujit në Vrellë kanë pasë me u furnizua Magurja, Vrella, Medveci, Dobraja e vogël, Lluga, Gllanica, Radeva, Lepia dhe Skullani dhe kërkesa ime ka qenë që të ndryshoj ky projekt dhe të hiqetn këto fshatra që janë në Komunën e Graçanicës dhe me projektin e ri të përfshihet Vërshevc, Blinaja, Ribari i Madh, Kraishta dhe këtë projekt do ta riprocedojmë dhe pres që të realizojmë këtë projekt.

U përmend Jeta e Re dhe Topliqani dhe ju them se asnjëherë nuk e kam pasë politikën përjashtuese.

Në vazhdim tha se kemi parapa lidhjen e rrugës me asfalt Grackë-Topliqan dhe kemi nënshkru marrëveshjen me Komunën e Shtimës për asfaltimin e rrugës Topliqan-Vojnovc.

Për emërtimin e kodeve të cilat i përmendi Petriti unë ju them se kemi probleme për emërtim të kodeve ku shembull po e marr zhavorimin e rrugëve që nuk ka kod dhe nuk mund të themi zhavorimi i rrugëve e gjithashtu edhe për qentë endacak nuk ka kod meqë nuk pranohet në nivelin qëndrorë që edhe unë po them se duhet të ndërmirret diçka për qentë endacak. Në fund tha se unë po sa erdha nga shoqata DEMOS-i dhe ju njoftoj se Komuna e Lipjanit është shpallë lidere dhe ka zëndë vendin e parë në Kosovë dhe kemi marrë mirënjohjen nga DEMOS-i dhe përveq mirënjohjes kemi fitu edhe një grant në shumë prej 75 mijë euro.

Petrit Kelmendi, unë pajtohem me Kryetarin se nuk mund të futen kodet me friballans por unë kërkoja që të njoftohemi se cilat rrugë janë, cilat fusha sportive në cilat lokalitete.

Blerim Gashi, falenderoj Kryetarin për mirënjohejen që kemi marrë dhe grantin që kemi fituar. Në vazhdim kërkoj që të bëhen përpjekje për përfundimin e rrugës 4 korsi meqë kjo po zgjatë shumë dhe po sjellë një imazh jo të mirë. Kur është fjala te rrjeti i ujësjellësit në vitin e kaluar janë ndërru disa gypa që kanë qenë prej azbesit por ende kanë mbet gypa të vjetër të azbestit e që janë konstatu se këta gypa janë kancerogjen, andaj kërkoj që këta gypa të hiqen sa më parë dhe të vendosen gypa të ri.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit për aprovimin e buxhetit për vitin 2016-2018 me vërejtjen që të kërkohej me shkrim nga Ministria për Financa për mbulimin e shpenzimeve në kategorinë paga dhe medijtje në shumë prej 201.320,00€ dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për; 9 kundër; asnjë abstenim, aprovoi Vendimin e buxhetit për vitet 2016-2018.

VENDIM MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2016-2018

Neni 1.

Me këtë Vendim aprovohet Buxheti për vitet 2016-2018 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Buxheti për vitet 2016-2018 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2016	VITI 2017	VITI 2018
Grant i Përgjithshëm	4,221,055.00	4,302,395.00	4,399,183.00
Grant Specifik i Arsimit	5,710,828.00	5,710,828.00	5,710,828.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,361,955.00	1,361,955.00	1,361,955.00
Të hyrat vetanake	1,650,000.00	1,870,000.00	1,890,000.00
TOTALI	12,943,838.00	13,245,178.00	13,361,966.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategoritë ekonomike si vijon:

KATEGORITË EKONOMIKE	VITI 2016	VITI 2017	VITI 2018
Paga e Mëditje	8,628,911.00	9,065,959.00	9,065,959.00
Mallra dhe Shërbime	722,630.00	894,697.00	894,697.00
Shërbime Komunale	188,390.00	188,390.00	188,390.00
Subvencione dhe Transfere	329,067.00	161,000.00	161,000.00
Investimet Kapitale	3,074,840.00	2,935,132.00	3,051,920.00
TOTALI	12,943,838.00	13,245,178.00	13,361,966.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë : Vendimi dhe kërkesa për Ministrinë për Financa për mbulimin e shpenzimeve në kategorinë paga dhe medijtje në shumë prej 201.320,00€. .

III

Propozim Vendim mbi miratimin e ridestinimit dhe transferit të mjeteve buxhetore për vitin 2015

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdinit Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, edhe me këtë vendim nuk janë përmend emërtimet e rrugëve dhe lumenjëve e gjithashtu është dashtë të përmendet edhe kontratat nga të cilat kanë mbetë mjetet.

Labinot Shahini, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë Vendim dhe është mirë që kanë tepër mjetet dhe shihet se asnjë kontratë nuk është tejkalu, andaj na si grup parlamentar e përkrahim.

Ali Stublla, te ndërtimi i rrethojave të shkollave në Kraishtë dhe "Ismajl Lumë" është thënë projekt i ri në shumë prej 18.500,00€ dhe unë e di se ky projekt është implementu dhe unë e kam të pa kjo projekt i ri ndoshta është dashtë me thënë ndryshe.

Florent Hoxha, është mirë që kanë mbetë mjete dhe me rishiqim të buxhetit kemi të drejtë me parapa projekte të reja kurse me ridestininim nuk e di a kemi të drejtë.

Te projektet e reja duhet të përmenden saktë se cilat rrugë janë meqë në Vendim thuhet rrugët lokale a nuk dihet se cilat rrugë.

Te rruga e Dobrajës planifikimi ka qenë 80 mijë euro a vlera e kontratës është 75 mijë euro ndërsa për ridestininim kanë mbetë 15 mijë euro kjo nuk është e kjarët se nuk ka mundësi të mbesin 15 mijë euro.

Për Shalë kërkoj që të përfshihet kanalizimi tërsisht meqë dy lagje janë parapa për kanalizim të cilat më herët për shkak problemeve pronësore nuk është kry kanalizim kurse tani janë parapa këto dy lagje ndërsa një lagje nuk është parapa fare. Kërkoj që edhe kjo lagje të përfshihet për kanalizim.

Ali Stublla, kanalizimi për Krojmir nuk ka përfundu, a këtu nuk është planifiku, ndërsa Shërbimet Publike kërkojnë që të përfundon ai projekt dhe pyes se a do të ket mjete për këtë kanalizim që të përfundon.

Xhevat Olluri, propozoj që nga mjetet e planifikuara për projekte të parashihet edhe hartimi i projektit për nxemje qëndrore të qytetit.

Ramiz Qeriqi, qka na duhet nënkalimi te hekurudha kur ne fëmijët gjatë sezonit të dimërit i qojmë me qizme në shkollë.

Enver Kozhani, kërkoj që me këtë ridestininim të parashihet ndërrimi i dyerëve dhe dritareve të shkollës në Ribar të Madh.

Imri Ahmeti, kërkesat janë reale por është mirë me këqyrë tërsinë e pastaj mbrenda tërësisë.

Sa i përket emërat e rrugëve që i përmendi Petriti nuk i kemi përmend meqë ka probleme edhe me emëra të rrugëve por kur kemi thënë rrugët në Sllovi ato dihet se janë në Sllovi.

Për rrethojat që i përmendi Alia ju them se për Kraishtë nuk është zhvilluar asnjë procedurë, kurse për Lipjan është bërë kontrate dhe është implementu por vetëm 3 pjesë janë kry kurse 1 ka mbetë pa u kry për këtë arsye është një pjesë e vogël për këtë shkollë kurse tjerat shkojnë për rrethojen e shkollës në Kraishtë.

Florenti e tha se është buxhet politik por ju them se nuk është buxhet politik se në Shalë kemi ndërhy edhe në kanalizim, ujësjellës, ndriqimi publik që besoj se është lëshu, ndërtimi i sallës dhe me këtë nuk po du me livdu se është obligim i yni po kur është mirë

duhet me thënë se është mirë e kur është keq edhe partia jem duhet me thënë se është keq.

Për nënkalim që e përmendi Xhevati është me vend por është problem me marr pëlqim prej hekurudhes.

Heset Sahiti, u tha pse nuk janë përmend cilët lumenjë unë ju njoftoj se janë Lumi në Qylagë, Janjevë, Banullë, Glllogovc etj.

Ramiz Qeriqi, nuk ju dha përgjigje Alisë për kanalizim në Krojmir.

Imri Ahmeti, problemi i kanalizimit në Krojmir është problem pronësor dhe neglizhimi i kompanisë së Aliut dhe i them Aliut kryeje punën mbrenda një muaji do të bëhet pagesa.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, 10 kundër, asnjë apstenim miratoi këtë:

VENDIM

MBI MIRATIMIN E RIDEDESTINIMIT DHE TRANSFERIT TË MJETEVE TË NDARJEVE BUXHETORE PËR VITIN 2015

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Ridestnimi dhe Transferi i mjeteve të ndara buxhetore për vitin 2015 siç është përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi.

Neni 2

Sipas këtij vendimi, Kryetari i Komunes pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave, mund të bartë mjetet buxhetore ashtu siç është përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi:

Neni 3

3.1. Mjetet Ridestnohen /Transferohen nga kjo ndarje buxhetore:

Mjetet nga mbetjet e projekteve në investime kapitale nga fondi burimor (10) të planifikuara në :

Zyren e Kryetarit *kodi i programit 16003:*

Tabela 1.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestnim/transfer
1	Pagesa për vendime gjyqësore	40141	126,137.00	-	18,920.00
	Totali:				18,920.00€

Drejtoratin, *Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike- 18163):*

Tabela 2.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestnim/transfer
1	Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Gadime e Ulet	40143	110,000.00	76,881.00	26,119.00
2	Asfaltimi i rrugëve ne Fshatin Brus	40144	50,000.00	48,305.50	1,694.50
3	Asfaltimi i rrugëve ne Fshatin Krojmir	40145	60,000.00	57,542.00	2,458.00
4	Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Sllovi-Smallush	40146	120,000.00	91,003.00	28,997.00
5	Asfaltimi i rrugëve ne Fshatin Magure	40148	100,000.00	92,065.6	7,934.40
6	Asfaltimi i rrugëve ne Fshatin Gadime	40150	50,000.00	49,892.79	107.21
7	Asfaltimi i rrugëve ne Fshatin Bujan	40151	60,000.00	41,488.81	18,511.19
8	Asfaltimi i rrugëve ne Fshatin Ribar i Madh	40152	65,000.00	64,199.85	800.15

	faza II				
9	Asfaltimi i rrugeve ne Fshatin Janjeve	40154	50,000.00	49,283.75	716.25
10	Rehabilitimi i Rrjeteve të kanalizimeve në (Kraishtë, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Poturovc, Torinë, Dobrajë e Madhe, Llugë) faza II	40157	56,460.97	49,345.40	2,615.57
11	Mirmbajtja e rrugeve te Asfaltuara	40160	10,000.00	-	10,000.00
12	Rregullimi i Varrezave	40162	10,000.00	-	10,000.00
13	Rehabilitimi i Ndrqimit Publik ne Gracke	40165	5,900.00	5,569.00	331.00
14	Rregullimi i Venndalimit te Autobuseve te Qendra Rinore Sportive	40168	20,000.00	18,516.00	1,484.00
15	Zgjerim i Rjetit të Kanalizimit brenda fshatrave Dobrajë, Ribar i Madh, Shalë	40159	50,000.00	29,824.20	10,175.80
16	Ndertimi i Ures dhe Shtratit te Lumit ne Fshatin Sillovi	84607	50,000.00	35,275.00	11,725.00
	Totali:				133,669.07€

Dejtoratin,Kulturë Rini dhe Spor, Kodi i Programit - 85003.

Tabela 3.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/ transfer
2	Ndërtimi i Fushave Sportive në fshatrat Janjevë, Sillovi, Gadime e Epërme	40205	20,000.00	19,512.37	487.63
	Totali:				487.63

Mjetet nga Investimet Kapitale nga fondi burimor (21) të planifikuara në:

Drejtoratin,Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163):

Tabela 4.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/ transfer
1	Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Rufc i Ri	40153	35,580.00	35,535.40	44.60
2	Mirmbajtja e rrugeve te Asfaltuara	40160	10,000.00	-	10,000.00
3	Pastrimi dhe Hapja e Lumenjeve	40164	20,000.00	15,400.00	3,100.00
4	Rregullimi i Parkingjeve në Qytetin e Lipjanit	40166	15,354.00	14,632.40	721.60
	Totali:				13,866.20€

Dejtoratin,Kulturë Rini dhe Spor, Kodi i Programit – 85003

Tabela 5.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/ transfer
1	Renovimi i Sallës në Shtëpinë e Kultures	40207	18,070.00	16,425.90	1,644.10
	Totali:				1,644.10€

Dejtoratin Planifikimi dhe Urbanizem– 66320

Tabela 6.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/transfer
1	Hartimi i projekteve detale	40200	130,000.00	-	19,480.00
	Totali:				19,480.00€

Dejtoratin Arsim dhe Shkence ,Administrata e Arsimit, Kodi i Programit – 92015

Tabela 7.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/transfer
1	Blerja e Paisjeve Elektrike per Kyqje te Shkollave	84612	15,000.00	-	15,000.00
	Totali:				15,000.00€

Totali i mjeteve të propozuara për Ridestitim/Transfer, të pasqyruara në tabelat 1,2,3,4,5,6,7 është 203,067.00€.

3.2 Mjetet nga pozicioni i lartëcekur në paragrafin 3.1 nga tabelat 1,2 dhe 3 te këtij neni, Ridestitohen /Transferohen në Tabelat 8,9,10,11.

Drejtoratin,Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163) – Fondi

Burimore 10:

Tabela 8.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/transfer
1	Asfaltimi i rugeve ne fshatin Dobraj e Madhe	40149	80,000.00	75,128.63	15,229.59
2	Rehabilitimi i Rrjeteve të kanalizimeve në (Kraishtë, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Poturovc, Torinë, Dobrajë e Madhe, Llugë) II	84570	9,019.97	-	1,764.00
3	Rregullimi i Lumenjeve	Projekt i ri	-	-	30,400.11
4	Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal	Projekt i ri	-	-	4,900.00
5	Ndertimi i rrugëve Lokale	Projekt i ri	-	-	15,000.00
6	Asfaltimi i rrugëve mbrenda fshatit Sllovi	Projekt i ri	-	-	26,200.00
7	Bashkfinancim me donatorë	40163	94,000.00	-	30,000.00
8	Rregullimi i Infrastruktures dhe Rrenimi i Objekteve te vjetra ne Magure	Projekt i ri	-	-	9,200.00
9	Zgjerimi dhe Riparimi i rrjetit te Kanalizimit ne fshatin Poturovc	Projekt i ri	-	-	6,520.00
	Totali:				139,213.70€

Dejtoratin,Kulturë Rini dhe Spor, Kodi i Programit – 85003-Fondi Burimor 10

Tabela 9.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/transfer
----	----------------------	------------------	-------------	-------------------	---

1	Renovimi i nxemjes qendrore ne Qendren Kulturore "Tahir Sinani"	Projekt i ri	-	-	3,673.00
	Totali:				3,673.00€

Dejtoratin,Administrata e Arsimit, Kodi i Programit – 92015: – Fondi Burimore 10:

Tabela 10.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/ transfer
1	Blerja e Inventarit per zyret e Administrates dhe Drejtorive per Shkollat e reja	Projekt i ri	-	-	8,700.00
	Vendosja e Ujembledhesve Atmosferik ne SH.F. Ismail Luma	84615	3,000.00	-	770.00
	Totali:				9,470.00€

Arsimi Fillor- Kodi i Programit – 93060: – Fondi Burimore 10:

Tabela 11.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/ transfer
	Rregullimi i infrastruktures ne SHF. Shtjefen Gjeqovi Brus	40216	2,737.00	-	720.00
	Totali:				720.00€

Mjetet nga pozicioni i lartëcekur në paragrafin **3.1** nga Tabelat **4,5,6 dhe 7** te këtij neni, Ridestinohe /Transferohen në Tabelat **12,13:**

Drejtoratin,Shërbimet Publike MCE (Nënprogrami i infrastrukturës publike-18163) – Fondi Burimore 21:

Tabela 12.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/ transfer
	Asfaltimi i rrugeve mbrenda fshatit Sllavi	Projekt i ri	-	-	30,366.30
	Zgjerimi dhe Riparimi i rrjetit te Kanalizimit ne fshatin Poturovc	Projekt i ri	-	-	1,124.00
	Totali:				31,490.30€

Arsimi Fillor- Kodi i Programit – 93060: – Fondi Burimore 21:

Tabela 13.

Nr	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Planifikimi	Vlera e kontratës	Mjetet e propozuara për ridestitim/ transfer
	Ndertimi i Rrethojave te SHF ne Kraishite , Ismail Luma ne Lipjan	Projekt i ri	-	-	18,500.00
	Totali:				18,500.00€

Totali i mjeteve të Ridestinuara/Transferuara është: 203,067.00€.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim Rregullore mbi caktimin e tarifave për tatimin në pronë.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim tha se kjo Rregullore nuk ka ndryshime nga Rregullorja e mëparshme por me Ligj parashihet që kur aprovohet buxheti duhet të aprovohet edhe Rregullorja për caktimin e tarifave për tatimin në pronë.

Meqë diskutime nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim Rregulloren dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për aprovoi këtë:

RREGULLORE

MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR TATIMIN NË PRONË

Shtesë: Rregullorja

V

Propozim Vendim për caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në Qendren për Edukimin dhe Arsimimin Parashkollor në Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Rasim Hasanit Drejtor i DKA-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, pyeti se a ka ndonjë Rregullore të brendshme që përcakton kriteret për pranimin e fëmijëve në Qerdhe.

Linda Shahini, unë më herët kam pas propozuar që për nënat vetë ushqyese t'u pranohen fëmijët në Qerdhe dhe pyes se a do të pranohet ky propozim.

Blerim Gashi, unë e di se kërkesat janë të mëdha për pranimin e fëmijëve në Qerdhe dhe nuk ka mundësi që të plotësohen të gjitha kërkesat por propozoj që të nxirret një Rregullore për përcaktimin e kriterëve për pranimin e fëmijëve në Qerdhe.

Edita Gashi, mendoj që për fëmijën e parë shuma duhet të rrumbullaksohet në 40 euro kurse për fëmijën e dytë dhe të tretë pajtohem me shumën e propozuar dhe Levizja Vetëvendosje e përkrah këtë Vendim.

Florent Hoxha, në Qerdhe janë kriteret për pranimin e fëmijëve dhe pa u plotësuar kriteret nuk pranohet në Qerdhe. U tha se me Ligj janë të parapara se cilat kategori lirohen nga pagesa andaj në këtë kategori propozoj që të lirohen nga pagesa edhe fëmijët e veteranëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së.

Hajrije Salihu, Qerdhja në Lipjan nuk ka vend për t'i pranua të gjithë fëmijët a këtu flitet për fëmijën e parë, dytë e tret etj. dhe unë kërkoj që të vendosen kriteret për pranim të fëmijëve në Qerdhe.

Ramiz Qeriqi, na po flasim për nxjerrjen e kriterëve a unë e di se Drejtori aktual i qerdhës i ka shkel kriteret se ka fëmijë të invalidëve që fare nuk paguajnë a ka edhe fëmijë tjerë të invalidëve që paguajnë si të don ai vendos.

Merita Hajrizi-Zeqiri, kushtet në qerdhe janë katastrofale dhe numri i fëmijëve është shumë i madh dhe për 30 fëmijë është një mësues.

Rasim Hasani, Qerdhja në Lipjan nuk mund t'i pranoj të gjithë fëmijët por për momentin mundësitë janë këto. Unë nuk kam informata se dikush është liruar nga pagesa e dikush jo po mendoj të të njejtës kategori.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni, vuri në votim propozimin e Vendimit me ndryshim të nenit 3 që u paraqit më herët për lirin nga pagesa e tarifave të përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet me dispozitat e përcaktuara me Ligj dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave aprovoi këtë:

VENDIM

MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR QENDRIMIN DITOR TË FËMIJËVE NË QENDRËN PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN PARASHKOLLOR NË LIPJAN

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen obligimet e prindërve për pagesën e tarifave, procedura për lirim nga pagesa e këtyre tarifave si dhe zvogëlimet e tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në Qendrën për edukim dhe arsimimin parashkollor në Lipjan.

Neni 2

Kompenzimi për qëndrim ditor

Prindërit, përkatësisht kujdestarët, për vendosjen e fëmijëve për qëndrim ditor në Qendrën për edukim para fillor në Lipjan, në emër të participimit për një fëmijë, për çdo muaj duhet të paguajnë shumën prej **45.00 €**.

Neni 3

Lirimi nga pagesa e tarifave

Lirimi nga pagesat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore .

Neni 4

Zvogëlimi i tarifave

Prindërit përkatësisht kujdestarët e fëmijëve do të paguajnë tarifën e zvogëluar për qëndrimin ditor për më shumë se një fëmijë, s'i vijon:

Për fëmijën e dytë shumën prej 31.50 €.

Për fëmijën e tretë shumën prej 22.50 €.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në Ueb faqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashanit Drejtor i DKRS, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Burbuqe Ilazi, grupi parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar këtë propozim Vendim dhe të njëjtin e përkrahim.

Daut Azemi, edhe na grupi parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Merita Hajrizi-Zeqiri, të gjitha grupet parlamentare po e përkrahin mirëpo me sa po duket shumë mjete po na i merr Bashkësia Islame.

Blerim Gashi, kërkoj nga ekzekutivi që të shiqon se si është e rregulluar kjo qështje në Komunitet tjerë me që qdo dytën mbledhje po merremi me këso vendime.

Meqë diskutime tjerë nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstato se Kuvendi me 29 vota për 1 kundër aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunitetit për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 7480 €, (shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro), për subvencionim të shpenzimeve të varrimeve, për 68 raste të vdekjes të cilat kanë ndodhur prej datës 02.06.2015 deri më 17.08.2015 me nga 110 Euro për secilin rast 110X68=7480.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunitetit për vitin 2015.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunitetit.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim Afatëshkurtër të pronave të paluajtëshme të Komunitetit-Tokave Bujqësore

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Feti Krasniqit Drejtor, i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, tha se është mirë që këto prona po ipen në shfrytëzim dhe pyeti se a ka mundësi që të identifikohen se cilat prona janë të uzurpuara.

Blerim Gashi, në 6 mujorin e parë Kryetari ka dhënë një raport të punës dhe ka premtu se qështjen e pronave komunale do ta zgjidh dhe ky është hapi i parë, andaj unë kërkoj që kjo punë të vazhdohet dhe e përkrahu këtë propozim Vendim.

Ali Stublla, për pronën në Topliqan në kopjen e planit janë 16 hektarë kurse në fletën poseduse 2.5ha andaj është mirë me u kufizu në kopjen e planit se ku është kjo pronë.

Nehat Terpeza, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe me këtë shihet se pronat komunale po evidentohen dhe po ipen në shfrytëzim andaj na e përkrahim këtë propozim.

Edita Gashi, ne jemi për me ju kriju mundësi investimeve por duke ditur faktin se me prona janë dallavere në Kosovë edhe në Komunitetin tonë dhe na nuk kemi besim në qeverisjen e juaj dhe nuk e përkrahim këtë Vendim.

Florent Hoxha, u tha se është mirë që po evidentohen pronat, mirëpo unë ju them se të gjitha pronat janë të identifikume por duhet të identifikohen shfrytëzuesit e paligjshëm të pronave. Në vazhdim tha se me nenin 6 të Rregullores thuhet qartë se Komuna e cakton çmimin fillestar e pastaj dihet se me ankand kush jep ma shumë e fiton të drejten për shfrytëzim.

Linda Shahini, unë dashta vetëm një sqarim të shkurtë meqë përfaqësuesja e Vetëvendosjes Edita tha se janë bërë shumë dallavere me prona dhe unë ju njoftoj se jam pjesë e një komisioni me Meritën dhe Ali Stubllen dhe ky komision ka funksionu në mënyrën më të mirë dhe për këtë jemi shpërbly nga USAI-di.

Xhevat Olluri, unë e përkrahi këtë propozim Vendim mirëpo para se toka të ipet në shfrytëzim është mirë që të njoftohen të gjithë ata që janë duke i shfrytëzu këto prona se këto prona do të ipen në shfrytëzim përmes procedurave në mënyrë që mos të ket telashe prapa.

Imri Ahmeti, unë i kam dhënë detyrë Departamentit të Bujqësisë që të bënë identifikimin e shfrytëzuesve të tokave bujqësore dhe është mirë që sot është ky propozim Vendim për dhënien e tokave në shfrytëzim dhe nëse ju nuk doni ta aprovoni mund ta lini këtë qështje. Na i kemi qitë në Web faqe të Komunës tokat që i kanë në shfrytëzim dhe konsideroj se kurr nuk i kanë paguar Komunës për shfrytëzimin e këtyre pronave, andaj në të ardhmen duhet ta rregullojmë këtë qështje.

Kemi shumë Vendime që Kuvendi ju ka dhënë në shfrytëzim tokën si shembull kemi 5 hektar në Ribar të Vogël për ndërtimin e fabrikës së etanolit, Benafit, dhe 5 hektar për ndërtimin e një ferme të dhive në Kraishtë e shumë të tjera e që sot e asaj dite nuk është ndërtu fare në këto toka dhe konsideroj se këto Vendime së shpejti duhet t'i anulohet meqë në bazë të Vendimeve ka qenë afati i caktuar se kur do t'i përfundojnë punimet.

Sa u përket lokaleve dhe banesave të cilat janë fitu me koncision ato janë të evidentuara dhe të regjistruara në kadastrë e që edhe për këto lokale dhe banesa do të vendosim sipas dispozitave ligjore në fuqi siqë kemi vendos edhe më herët për disa lokale.

Sefer Tasholli, Kryetari Buja gjatë mandatit të tijë ka dhënë disa prona në shfrytëzim sipas Rregullores që ka qenë në fuqi ku për toka bujqësore çmimi ka qenë 25 euro për hektarë, ndërsa 4 euro m² për lokale afariste por tani kjo Rregullore është shfuqizuar dhe ne duhet të punojmë sipas ligjeve në fuqi për këto çështje.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pika Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se me 28 vota për, 2 kundër aprovoi këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS-TOKAVE BUJQËSORE

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronave të paluajtshme të Komunës -tokave bujqësore, që gjenden në ngastrat kadastrale si në vijim:

Nr.	Pronar	Zona Kadastrale	Ngastra Kadastrale	Sipërfaqja	Kultura	Boniteti/klasa
1	KK Lipjan	Dobrajë e vogël	P-71409049-00051-0	24758 m ²	Bujqësore	Klasit 1
2	KK Lipjan	Bujan	P-71409008-00371-0	32180 m ²	Bujqësore	Klasit 5
3	KK Lipjan	Topliqan	P-71409085-00968-	25146	Bujqësore	Klasit 2

			1	m ²		
4	KK Lipjan	Babush i Muhaxher ë	P-71409059-00559-0	70669m ²	Bujqësore	Klasit 4

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të cekura është që sipërfaqet bujqësore nëpërmjet procedurës së ankandit publik tu ipen në shfrytëzim personave fizik dhe juridik të interesuar që merren me veprimtari bujqësore sipas dispozitave të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe krijimi i të hyrave vetanake për Komunën.

Neni 3

Në pajtim me nenin 1 të këtij Vendimi pronat e cekura ipen në shfrytëzim në afat prej 10 (dhjetë) viteve, nëpërmjet procedurës së ankandit publik, ku do të përcaktohet çmimi fillestar për secilën pronë duke u bazuar në vendndodhjen e pronës dhe bonitetin e saj, ndërsa do të kenë mundësi të përfitojnë personat fizik dhe juridik që ofrojnë çmimin më të lartë.

Neni 4

Procedurën e Ankandit publik e udhëheqë Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.404-13205 të datës 31.03.2014, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në fagen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 13,³⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni